

*Mali i Zi në*

# INTEGRIMET EVROPIANE





NEW HORIZON

*MALI I ZI në*

# INTEGRIMET EVROPIANE



*Botues:*

*Organizata e Shoqërisë Civile*

*HORIZONTI i RI - Ulqin*

*[www.ngo-horizonti.org](http://www.ngo-horizonti.org)*

*Për botuesin:*

*Nazif Veliqi*

*Përgatitja teknike:*

*Omer Musliçiq*

*Shtypi:*

*PRESS STUDIO, Ulqin*

*Publikimi i kësaj broshure  
u mundësua nga*



**KUVENDI I MALIT TË ZI**  
*Komisioni për ndarjen  
e mjeteve OJQ-ve  
(Konkursi i v. 2008)*



Fillimi i procesit të integritimit evropian e ka zanafillën e vet në 9 maj të vitit 1950, kur Ministri i Jashtëm francez, Robert Shuman, paraqiti propozimin e tij për krijimin e një bashkësie e cila do të qëndronte mbi kombet e ndryshme, një Evropë të organizuar, të domosdoshme për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore mes shteteve anëtare të saj. Propozimi i njohur si “Deklarata Shuman” konsiderohet si hapi i parë drejt integritimit evropian dhe 9 maji është deklaruar si festa e Evropës.



Pak histori ...

Në 9 maj të vitit 1950 lindi Evropa komunitare, pikërisht atëherë kur kërcënimi i fillimit të një lufte të re botërore kishte pushtuar mbarë Evropën. Atë ditë, në Paris, përfaqësues të shtypit ishin mbledhur në orën gjashtë të pasdites në Quai d'Orsay, selia e Ministrisë së Jashtme, për një komunikim tepër të rëndësishëm.

Rreshtat e parë të deklaratës së 9 majit 1950, të përgatitur nga Robert Shuman, ministri francez i Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me mikun dhe këshilltarin e tij Monet, të krijojnë një ide të qëllimeve ambicioze të këtij propozimi. “Paqja botërore nuk mund të ruhet pa iniciativa krijuese që qëndrojnë në nivelin e rreziqeve që na kërcënojnë”. “Duke bashkuar të tilla produkte bazë dhe duke ndërtuar një Autoritet të Lartë, vendimet e të cilit do të jenë të detyrueshme për Francën dhe Gjermaninë si dhe për vendet e tjera që do të aderojnë, do të realizohen themelet konkrete të një federate evropiane të domosdoshme për ruajtjen e paqes në kontinentin tonë”.

Me këtë propozim, zë fill krijimi i një institucioni evropian, që të qëndronte mbi shtetet, të cilit do t'i besoheshin menaxhimi i çështjeve parësore që në atë periudhë ishin në qendër të vëmendjes së çfarëdo fuqie ushtarake: qymyri dhe çeliku.



## Lindja e KEQÇ

Pas fjalimit të rëndësishëm të Shumanit të 9 majit 1950, brenda pak kohësh nisën punimet përgatitore për krijimin e një bashkësie mbishtetërore në fushën e qymyrit dhe të çelikut. Në këtë vazhdë, pikërisht në 18 prill të vitit 1951, në Paris u firmos Traktati i Komunitetit Evropian për Qymyrin dhe Çelikun (KEQÇ) Në këtë traktat aderuan gjashtë vende: Belgjika, Franca, Gjermania, Holanda, Italia dhe Luksemburgu.

## KEE dhe Euratom


Menjëherë pas krijimit të KEQÇ procesi i integritimit evropian vijoi me ngritjen e institucioneve të tjera. Pas përpjekjeve të pasuksesshme për krijimin e KEM (Komuniteti Evropian i Mbrojtjes), përpjekje këto ndoshta tepër ambicioze – duke pasur parasysht periudhën historike – u vendos që të veprohej shkallë-shkallë. Mbërrijmë kështu në vitin 1955, kur me Konferencën e Mesinës marrin udhë negociatat për krijimin e dy komuniteteve të reja evropiane: Komuniteti Ekonomik Evropian, i themeluar në 25 mars 1957 në Romë me traktatin e njohur si Traktati i Romes dhe Komuniteti Evropian për Energjinë Atomike, i njohur si Euratom (KEEA). Shtetet që nënshkruan këto dy traktate të reja ishin të njëjtët: Belgjika, Franca, Gjermania, Holanda, Italia dhe Luksemburgu. Pika më e rëndësishme e Traktatit KEE ishte krijimi gradual i Tregut të Përbashkët Evropian si dhe krijimi i një Politike Agrare të Përbashkët.

## Traktati i Brukselit

Me krijimin e dy traktateve të mësipërme, u vu re një “grumbull” institucionesh, pasi çdo komunitet kishte 4 institucione të veçanta, katër për KEE dhe po aq për KEEA dhe KEQÇ. Nisën kështu, jo pa probleme, bisedimet për bashkimin e institucioneve të këtyre tre komuniteteve. Problemet lidheshin me nevojat e ndryshme të shteteve anëtare për t'i dhënë pushtet secilit prej institucioneve.



Në 8 prill 1965 u firmos një traktat i rëndësishëm, Traktati i Brukselit, i cili vendosi krijimin e një Këshilli të vetëm si dhe të një Komisioni të vetëm për të tre komunitetet evropiane.





## Vitet '80

Vitet '80 njihen në historinë e Evropës si vite të “qeta”. Greqia bëhet pjesë e Komunitetit Evropian në vitin 1981 dhe menjëherë nis të kërkojë financime. Anglezët, nga ana e tyre, kërkojnë një riekulibrim të dhënie-marrjes në sistemin e kontributeve e financimeve evropiane (pasi Britania e Madhe derdhte më shumë kontribute, por përfitonte shumë pak financime). Me krijimin e Këshillit Evropian në Fontenblò (Francë), në vitin 1984, arrihet në zgjidhjen e problemit britanik, duke përcaktuar se çdo vit në bilancin komunitar, do të ngrihej një shifër e përcaktuar në favor të Britanisë së Madhe. Por, vitet '80 janë dhe vite të rinisjes së procesit të integritimit evropian. Në vitin 1986 bashkohen me komunitetet Spanja dhe Portugalia, dhe menjëherë pas tyre firmosen marrëveshje të rëndësishme për realizimin e akteve komunitare.

Në vitin 1986, në Luksemburg u nënshkrua Akti Unik Evropian, një traktat i rëndësishëm që shënoi një hap themelor përpara në procesin e integritimit evropian e mbi të gjitha, vendosi bazat për një bashkëpunim mes vendeve anëtare në fushën e politikës së jashtme.



## *Evropa e pesëmbëdhjetëshe*

*Në 1 Janar 1995, tre vende të reja bashkohen me BE-në: Austria, Finlanda dhe Suedia, të cilat do të pasurojnë Bashkimin me veçoritë e tyre dhe do të hapin dimensione të reja në zemër të Evropës qendrore dhe asaj veriore. Dy sfida të mëdha paraqiten sot përballë Bashkimit të Pesëmbëdhjetëve*

*- zgjerimi me dhjetë vendet e Evropës qendrore dhe lindore, dhe Qipron, me të cilat Këshilli Evropian ka vendosur për fillimin e negociatave të anëtarësimit që në pranverën e vitit 1998;*

*- shfrytëzimi i dinamikës së Bashkimit monetar, i cili mbi bazën e kalimit në Euro, duhej t'u sigurojë ekonomive të vendeve anëtare një konvergjencë më të mirë dhe kushte për një rritje të qëndrueshme.*

*Falë gjithë procesit të integritimit evropian, pas shumë viteve të lodhshme, u arrit krijimi i konceptit të Bashkimit Evropian. Një Bashkim, i cili ka ende shumë rrugë për të bërë në drejtim të afirmimit të tij në skenat ndërkombëtare. Bashkimi Evropian është sot një shtet i madh me 370 milionë banorë, i përbërë nga 15 shtete anëtare. Ai ka simbolet e veta: flamurin dhe himnin e tij. Rruga e tij drejt forcimit të objektivave të arritura dhe arritjes së objektivave të reja, është ende e gjatë, veçanërisht pas hyrjes në qarkullim që nga janari i vitit 2002 i Euros, monedhës së përbashkët të më shume se 300 milionë qytetarëve*



Flamuri i Bashkimit Evropian paraqet një fushë blu, në të cilën janë vendosur 12 yje në formë rrethore, në mënyrë të tillë që një nga cepat sheh lart dhe dy të tjerat mbështeten drejt mbi një vijë të drejtë imagjinare perpendikulare me shkopin e flamurit. Yjet janë vendosur në mënyrë të njëjtë me orët në fushën e një sahati dhe numri i tyre është i pandryshueshëm.



Përdorimi i flamurit evropian nga palët e treta nuk duhet të krijojë konfuzion mes përdoruesit dhe Bashkimit Evropian apo Këshillit të Evropës e as të lidhet me objektiva apo veprimtari që janë në kundërshtim me parimet dhe qëllimet e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës



*Himni evropian ("Himn për gëzimin") është një përshtatje e lëvizjeve të fundit të Simfonisë së Nëntë të Beethovenit, realizuar nga Herbert von Karajan, sipas kërkesës së Këshillit Evropian në tre versione instrumentale: për piano solo, flaut dhe orkestër simfonike. Versioni zyrtar i tij, i cili është përdorur nga Këshilli Evropian në vitin 1972 dhe nga Bashkimi Evropian që nga viti 1986, është regjistruar në Lisbonë në vitin 1994*



## VENDET ANËTARE NË BASHKIMIN EVROPIAN

- *Austria, ka aderuar në BE në janar të vitit 1995;*
- *Belgjika, ka pasur gjithnjë një rol parësor në skenën evropiane. Ajo është një nga vendet themeluese të Komunitetit Evropian;*
- *Britania e Madhe, është bashkuar me BE së bashku me Danimarkën dhe Irlandën në janar të vitit 1973. Ka pasur gjithnjë sjellje skeptike ndaj integritimit evropian dhe veçanërisht ndaj monedhës së re. Nuk bën pjesë në Eurozonë*
- *Danimarka, ka aderuar në BE njëkohësisht me Britaninë e Madhe dhe Irlandën në janar të vitit 1973. Së bashku me Britaninë, është një nga shtetet më skeptike lidhur me potencialitetin e integritimit evropian. Nuk bën pjesë në 12 vendet e Eurozonës*
- *Finlanda, ka hyrë në BE së bashku me Austrinë dhe Suedinë në janar të vitit 1995. Afërsia me BRSS-në e ka mbajtur për shumë vite veçmas pjesës tjetër të Evropës, por menjëherë pas rënies së Bashkimit Sovjetik kërkoi të bëhej pjesë e BE-së. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Franca, është një nga gjashtë vendet themeluese të KE-së. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Gjermania, është një nga gjashtë vendet themeluese të KE-së. Duke qenë vendi me ekonomi më të fortë brenda Komunitetit, ka luajtur gjithnjë një rol të rëndësishëm në vendimmarrje. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Greqia, është bashkuar me KE në janar të vitit 1981. Është një nga vendet më të varfra të Bashkimit dhe për këtë ka përfituar një numër të konsiderueshëm ndihmesh ekonomike nga vetë Komuniteti. Bën pjesë në Eurozonë*



- *Holanda, është një nga gjashtë vendet themeluese të KE-së. Dy nga traktatet më të rëndësishme të historisë së integrimit evropian janë nënshkruar në territorin holandez: Traktati i Mاستrihtit dhe ai i Amsterdimit. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Irlanda, është bërë pjesë e KE-së në janar të vitit 1973. Ajo është një vend neutral, ndaj refuzon pjesëmarrjen në mbrojtjen e përbashkët evropiane. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Italia, është një nga gjashtë vendet themeluese të BE-së. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Luksemburgu, është shteti më i vogël i KE-së, por është njëkohësisht edhe një nga shtetet që kanë themeluar këtë Komunitet. Ai është që nga fillimet e tij një nga mbështetësit e zjarrtë të integrimit evropian. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Portugalia, së bashku me Spanjën është pranuar në BE në vitin 1986. Së bashku me Greqinë është një nga vendet më të varfra të BE-së dhe përfiton ndihma të shumta evropiane. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Spanja, ka hyrë në KE në vitin 1986, pas një periudhe izolimi të gjatë në nivel ndërkombëtar. Bën pjesë në Eurozonë*
- *Suedia, është bashkuar me KE njëkohësisht me Austrinë dhe Finlandën, në janar të vitit 1995. Nuk bën pjesë në Eurozonë*
- *Republika Çeke aderoi në BE në 1 maj 2004.*
- *Estonia aderoi në BE në 1 maj 2004*
- *Qipro aderoi në BE në 1 maj 2004*
- *Letonia aderoi në BE në 1 maj 2004*
- *Lituania aderoi në BE në 1 maj 2004*
- *Hungaria aderoi në BE në 1 maj 2004*
- *Malta aderoi në BE në 1 maj 2004*
- *Polonia aderoi në BE në 1 maj 2004*
- *Sllovenia aderoi në BE në 1 maj 2004 dhe hyri*

• *Bashkimi Evropian është një familje e madhe e vendeve demokratike evropiane, të angazhuara të punojnë së bashku për paqe dhe prosperitet. Nuk është një Shtet që kërkon të zërë vendin e shteteve ekzistuese, por është më tepër se çdo organizatë tjetër ndërkombëtare. Në fakt, Bashkimi Evropian është i vetëm. Shtetet anëtare të tij kanë ngritur institucione të përbashkëta, ku kanë deleguar një pjesë të sovranitetit të vet, me qëllim që vendimet mbi çështje me interes të përbashkët të merren në nivel evropian dhe në mënyrë demokratike.*

*Evropa është një kontinent me shumë tradita dhe ku fliten gjuhë të ndryshme, por edhe me shumë vlera të përbashkëta. Bashkimi Evropian i mbron këto vlera. Ai ushqen bashkëpunimin midis popujve të Evropës, nxit idenë e bashkimit të tyre ndërsa ruan origjinalitetin e secilit, dhe kujdeset që vendimet të merren sa më pranë qytetarëve evropianë.*

*Në një botë gjithnjë e më shumë të ndërvarur të shekullit të XXI, spikat akoma më shumë nevoja që çdo qytetar evropian të bashkëpunojë me njerëz nga vende të tjera me një frymë njohjeje, tolerance dhe solidariteti.*



## TË JESHË QYTETAR I BASHKIMIT EVROPIAN

Në qoftë se je qytetar i Bashkimit Evropian, mund të udhëtosh, të studiosh dhe të punosh në çdo vend të Bashkimit Evropian. Gjithnjë e më shumë, Bashkimi Evropian po punon që t'i sigurojë qytetarëve të tij më shumë liri lëvizjeje, si një nga të drejtat themeltare të tyre, dhe të mënjanojë çdo lloj diskriminimi në bazë kombësie.

Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian mund të udhëtohet pa patur pasaportë me vete, pa hasur pengesa doganore në kufi. Me pak përjashtime, mund të blihet çdo gjë dhe të transportohet në vendbanimin përkatës.

Bashkimi Evropian nuk vendos se çfarë mësohet në shkollë, por ama ai sigurohet që kualifikimet profesionale dhe arsimore të njihen në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian punon që nëpërmjet skemave të shkëmbimit dhe të partneriteteve, t'i sigurojë mundësi për t'u shkolluar çdo qytetari brenda dhe jashtë vendit, duke shmangur kështu procedurat burokratike.





Mbrojtja e vendit të punës dhe krijimi i vendeve të reja është një nga detyrat kryesore të Bashkimit Evropian. Industria evropiane nuk do të mund të sigurojë vende të reja pune nëse kushtet ekonomike nuk janë të favorshme. Pikërisht, krijimi i kushteve të favorshme është ai për të cilin punon Bashkimi Evropian.

Nëpërmjet krijimit të një tregu pa barriera kufitare dhe qarkullimit të së njëjtës monedhë, euro, Bashkimi Evropian tashmë i ka dhënë një shtysë të madhe tregtisë dhe punësimit në Evropë. Ai ka një strategji të përbashkët për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe për gjenerimin e një numri më të madh të vendeve të punës. Pozicionet e së nesërme do të krijohen nëpërmjet punës kërkimore, edukimit dhe trainimit, shpirtit të sipërmarrjes, adoptimit të mënyrave të reja të të punuarit dhe dhënies së mundësive të barabarta për punë.

Një e treta e buxhetit të Bashkimit Evropian shkon për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe të punëxënies në vendet më pak të zhvilluara. Kështu, mirëqenia e Evropës shpërndahet në mënyrë më të njëtrajtshme.



## ÇFARË ËSHTË INTEGRIMI EVROPIAN

Në rastin e integrimit evropian pjesët (e sistemit) që integrohen janë shtetet kombëtare. Ajo që shtetet kombëtare humbasin gjatë procesit të integrimit evropian është sovraniteti, që do të thotë se për një numër të konsiderueshëm çështjesh vendimet nuk mund të merren më prej qeverive të shteteve kombëtare, por prej institucioneve të Bashkimit Evropian. Ndërsa ajo që shtetet kombëtare fitojnë gjatë integrimit evropian është solidariteti, il kuptuar si treg i përbashkët, mbrojtje e përbashkët, monedhë e përbashkët, politikë bujqësore e përbashkët etj.

Nga ana tjetër, solidariteti që rrjedh prej integrimit evropian bazohet në disa vlera themelore të përbashkëta, të cilat duhet t'i respektojnë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe ato vende që dëshirojnë të anëtarësohen në të. Këto vlera shpesh grupohen në të ashtuquajturat kritere, si më poshtë:

### *Kriteri politik:*

*Demokracia, Shteti i së drejtës, Mbrojtja e të drejtave të njeriut, Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteve*

### *Kriteri ekonomik:*

*Ekonomi tregu funksionale, e aftë të përballojë presionet konkurruese dhe forcat e tregut të BE-së*

### *Kriteri administrativ*

*Aftësia për të përballuar detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian*

# MALI I ZI NË INTEGRIMET EVROPIANE

Ndonëse edhe në kohën e RSF të Jugosllavisë Mali i Zi ka qenë pjesë e procesit të bashkëpunimit me Bashkësinë Evropiane, marrëdhëniet e ngushta të Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian fillojnë pas referendunit mbi pavarësinë e Malit të Zi të datës 21 maj 2006.

Subjektiviteti juridik ndërkombëtar i Malit të Zi të pavarur u confirmua me anëtarësimin në Kombet e Bashkuara më 28 qershor 2006, një muaj pas referendunit. Ndërkohë, mbi bazën dypalëshe, Malin e Zi e njohën një numër i madh vendesh, me shumicën e të cilave janë vendosur marrëdhënie diplomatike.

Qysh në fillim të qershorit të vitit 2007, Bashkimi Evropian dhe vendet e tij anëtare vendosën të zhvillojnë marrëdhënie me Malin e Zi. Ky është një hap historik i 25 shteteve anëtare të atëhershme, ngase Bashkimi Evropian mori për herë të parë një vendim kolektiv të këtij lloji.

Në korrik të vitit 2007 Komisioni Evropian përgatiti propozimin e direktivës negociatore ndaj Këshillit të Evropës, i cili e miratoi me procedurë të shkurtër në seancën e datës 24 korrik 2007 dhe autorizoi Komisionin Evropian që të hapë, gjegjësisht të vazhdojë negociatat mbi Marrëveshjen e stabilizim-asociimit me Malin e Zi.

*Këto bisedime filluan në tetor të vitit 2005, derisa Mali i Zi ishte pjesë e bashkësisë shtetërore Serbia dhe Mali i Zi.*

*Pas disa runde bisedimesh politike dhe teknike, Marrëveshja e stabilizim-asociimit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian u nënshkrua më 15 mars 2007 në Podgoricë.*

*Pas nënshkrimit të Marrëveshjes mbi stabilizim-asociimin më 15 tetor 2007 në Luksemburg, si dhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së përkohshme mbi tregtinë dhe çështjet e ngjashme, Mali i Zi u kyç thellësisht në procesin stabilizim-asociimit në Bashkimin Evropian.*


*Marrëveshja e stabilizim - asociimit u mbështet njëzëri nga të gjitha partitë parlamentare dhe u ratifikua në Kuvendin e Malit të Zi më 13 nëntor 2007, kurse Parlamenti Evropian dha pëlqimin më 13 dhjetor 2007.*

*Marrëveshja e përkohshme filloi të zbatohet nga data 1 janar 2008.*



*U themelua Këshilli i përkohshëm, i cili në mbledhjen e parë më 22 janar 2008 miratoi Rregulloren e punës dhe rregullat për punën e nënkëshillave.*






Nënkëshilli i parë, për tregun e brendshëm dhe konkurrencë, u mbajt më 10 mars 2008, kurse gjatë vitit 2008 u mbajtën edhe mbledhjet e katër nënkëshillave të tjerë për ndjekjen e implementimit të Marrëveshjes

Po ashtu, me Vendimin e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian të datës 15 shtator 2006 është vendosur dialogu i rregullt politik midis Qeverisë së Malit të Zi dhe përfaqësuesve të institucioneve të BE-së në rangun e ministrave, kurse dialogu i parë politik është zhvilluar më 22 janar 2007, e pastaj më 18 shkurt 2008.

Këshilli i BE-së më 22 janar 2007 mori vendim për miratimin e Partneritetit të ri Evropian për Paqe me Malin e Zi, në të cilin janë përkufizuar objektivat afatmesme dhe afatshkurtra që duhet t'i përmbushë Mali i Zi për të qenë eventualisht pjesë e BE-së.

Nga qershori i vitit 2005, kur u miratua Deklarata e Kuvendit të Malit të Zi mbi integrimet evropiane, e deri në fund të vitit 2007, Qeveria e Malit të Zi dërgoi dhjetë raporte tremujore gjithëpërfshirëse mbi aktivitetet e realizuara në procesin e integrimi evropiane.

Kuvendi i Malit të Zi më 27 dhjetor 2007 miratoi dokumentin e ri, Rezolutën mbi përmbushjen e detyrimeve të Malit të Zi në kuadër të Marrëveshjes mbi stabilizim - asociimin.



*Përndryshe, marrëdhëniet midis Malit të Zi dhe bashkësive evropiane të atëhershme datojnë nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar.*

*Institucionalizimi i marrëdhënieve midis Malit të Zi dhe bashkësive evropiane të atëhershme, filloi më 2 dhjetor 1967, kur është nënshkruar Deklarata mbi marrëdhëniet midis RSFJ dhe Bashkësisë Ekonomike Evropiane (BEE), që kryesisht shtrihet vetëm në sferën e bashkëpunimit ekonomik.*


*Kurioziteti i këtij dokumenti qëndron në faktin që ky ishte akti i parë të cilin BEE e kishte lidhur me një shtet socialist të Evropës, në praktikën e saj të deriatëhershme njëzetvjeçare.*

*Deklarata shumë shpejt u ndoq nga nënshkrimi i dy marrëveshjeve tregtare midis RSFJ të Jugosllavisë dhe BEE-së, që u lidhën në vitet 1970 dhe 1973 - është fjala për marrëveshjet me të cilat RSFJ fiton statusin e preferencialit më të lartë, me koncesione reciproke.*

*Nga data 1 korrik i vitit 1971, RSFJ ishte bërë edhe shfrytëzuese e Skemës së përgjithshme të preferencialeve të BEE-së, pas të cilës pasoi edhe nënshkrimi i Marrëveshjes mbi bashkëpunimin midis RSFJ dhe BEE, që u nënshkrua në Beograd më 2 prill 1980. Me Marrëveshje rregullohet shkëmbimi i mallrave, bashkëpunimi financiar, kooperimi industrial, bujqësia, komunikacioni, turizmi, bashkëpunimi tekniko-shkencor, si dhe bashkëpunimi në sferën sociale.*








*Interesin e BEE-së për zhvillimin e bashkëpunimit me RSFJ e dëshmon edhe niveli i ndihmës financiare dhe teknike që është parashikuar me Marrëveshjen e bashkëpunimit nga viti 1980 dhe që përcaktohet me Protokollet mbi bashkëpunimin financiar.*

*Marrëveshja e bashkëpunimit nga viti 1980 është plotësuar në vitin 1987, me qëllim të liberalizimit të mëtutjeshëm të tregtisë.*

*Më 17dhejtor të vitit 1990 Jugosllavia nënshkroi Marrëveshjen kuadër PHARE, me të cilën bashkëpunimi reciprok zgjerohet edhe në sferën e ndihmës për reforma sociale dhe ekonomike, me anë të shfrytëzimit të masave financiare dhe teknike.*

*Vetëm një vit më vonë, në kohën kur RSFJ institucionalisht dhe financiarisht ishte mjaft e lidhur me bashkësitë evropiane të asaj kohe dhe kur kishte statusin që do të mund të konsiderohej edhe më i volitshëm karshi statusit që do të fitojnë shtetet e ardhshme të asociuara, shpërthejnë konfliktet brenda territorit të saj, e pastaj aplikohen edhe sanksione nga Bashkësia Evropiane për tërë territorin e Jugosllavisë dhe bëhet denoncimi i Marrëveshjes mbi bashkëpunimin RSFJ/BEE.*



*Mali i Zi, si pjesë e RF të Jugosllavisë, vetëm në vitin 1998 e rivendosi bashkëpunimin me BE-në. Në prill të vitit 1998, Këshilli i Evropës i akordoi Qeverisë malazeze tre milionë euro si ndihmë afatshkurtër për vazhdimin e programit të reformave ekonomike dhe politike.*


*Në dhjetor të vitit 1998, Komisioni Evropian dhe Qeveria e Malit të Zi dakordojnë programin e ndihmave në shumën pesë milionë euro, si mbështetje për procesin e reformave politike dhe ekonomike në Mal të Zi. Programi mbulonte sektorët e bujqësisë, transportit, administratës publike dhe arsimit.*

*Edhe në vitet që pasojnë, BE vazhdoi mbështetjen financiare, humanitare dhe teknike të Malit të Zi.*

*Marrëdhëniet ndërmjet Malit të Zi dhe BE-së në Procesin e stabilizim-asociimit janë vendosur në korrik të vitit 2001, me themelimin e Grupit të përbashkët konsultativ të punës RFJ-BE.*

*Faza e parë në kuadër të Procesit të stabilizim-asociimit vazhdoi me mbledhjet në formën e "Dialogut të avancuar të vazhdueshëm", që ka qenë model për vlerësimin e procesit të reformave politike, ekonomike dhe institucionale.*





Mbledhja e parë e DAV është mbajtur më 2 korrik 2003 dhe i është kushtuar jurisprudencës dhe punëve të brendshme, gjegjësisht sistemit legjislativ dhe ndëshkimit, reformës së policisë, luftës kundër kriminalitetit dhe korrupsionit, terrorizmit, kufijve, regjimit të vizave dhe strehimit politik.

Pas akordimit të Planit aksionar për harmonizimin e sistemeve ekonomike të Serbisë dhe Malit të Zi nga ana e Kuvendit të SMZ, Komisioni i Bashkimit Evropian filloi hartimin e Studimit të zbatueshmërisë.

Studimi i zbatueshmërisë u miratua në vitin 2005 dhe po në këtë vit filluan bisedimet mbi Marrëveshjen e stabilizim-asociimit.

Fakti që Mali i Zi, sikurse edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, mund të llogarisin në anëtarësimin potencial në BE definitivisht u bë i qartë kur në vitin 2003 liderët e vendeve të BE-së në Samitin e Selanikut konstatuan që të gjitha vendet e këtij rajoni kanë perspektivë evropiane.


Në Samit u arrit marrëveshja që për secilin shtet të Ballkanit Perëndimor të formulohen reformat afatshkurtra dhe afatmesme që duhet të zbatohen, në bazë të të cilave do të akordohen mjetet e nevojshme financiare dhe do të vlerësohet efekti i arritur, respektivisht progresi i realizuar.

# PROGRAMI NACIONAL PËR INTEGRIM (PNI)

- *Vlerësohet si*
- *Plan strategjik gjithëpërfshirës dhe kornizë pesëvjeçare e harmonizimit të legjislacionit, e formimit të kapaciteteve administrative, përfshirë edhe numrin e të punësuarve, si dhe të nevojave financiare nga buxheti dhe nga mbështetja e BE-së*
- *Dokumenti kyç i Qeverisë deri në vitin 2012*



MALI I ZI PARAQITI KËRKESËN PËR  
ANËTARËSIM NË BE- më 15 dhjetor të vitit  
2008





MALI I ZI

Podgoricë, 15.12.2008

SHKËLQESIA JUAJ, ZOTI PRESIDENT

NË EMËR TË SHTETIT TË MALIT TË ZI, DUKE NDJEKUR REZOLUTËN E KUVENDIT TË MALIT TË ZI MBI DETYRIMET NË KUADËR TË PROCESIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT ME BASHKIMIN EUROPIAN, KEMI NDERIN TË PARAQESIM KËRKESËN PËR ANËTARËSIMIN E MALIT TË ZI NË BASHKIMIN EUROPIAN.

Përfitojmë edhe nga ky rast, Shkëlqesia Juaj, që t'ju dërgojmë shprehjet e respektit tonë më të thellë,

Presidenti i Malit të Zi

Kryeministri

Kryetari i Kuvendit

Shkëlqesia e tij,

.....

Kryetari i Këshillit të Unionit Evropian

## KUSHTET E ANËTARËSIMIT NË BE

*NENI 49 i Traktatit me BE-në:*

*"Secili shtet evropian i cili respekton parimet e përmendura në nenin 6, pika 1, mund të kërkojë që të bëhet anëtar i BE-së..."*

*NENI 6 pika 1:*

*"Bashkimi Evropian mbështetet mbi parimet e lirisë, demokracisë, pushtetin e së drejtës, mbi parimet që janë të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare".  
Ndërkaq, BE-ja rezervon të drejtën e vendosjes se kur mund të jetë e gatshme për t'i pranuar anëtarët e rinj!*



## FAZAT NË PROCESIN E FITIMIT TË STATUSIT TË KANDIDATIT

- VENDIMI I KËSHILIT TË MINISTRAVE MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E "AVIS"-it POZITIV (MENDIMIT POZITIV)
- PYETËSORI I KOMISIONIT EUROPIAN
- PËRGATITJA DHE DËRGIMI I PËRGJIGJJEVE NGA PYETËSORI NGA ANA E MALIT TË ZI
- SHQYRTIMI I PËRGJIGJJEVE NGA ANA E KOMISIONIT EUROPIAN
- ÇËSHTJET SUPLEMENTARE
- KOMISIONI EUROPIAN PËRGATIT "AVIS"-in (MENDIMIN POZITIV) DHE IA DËRGON KËSHILLIT TË BE-së.
- NË BAZË TË MENDIMIT POZITIV TË KËSHILIT TË BE-së, KËSHILLI I EUROPËS I CAKTON MALIT TË ZI STATUSIN E KANDIDATIT PËR ANËTARËSIM NË BE.
- FILLIMI I NEGOCIATAVE
- FILLIMI I SCREENING-ut
- MENDIMI I KOMISIONIT EUROPIAN LIDHUR ME KËRKESËN E MALIT TË ZI PËR ANËTARËSIM NË BE
- PROCESI I VERIFIKIMIT TË GATISHMËRISË SË VENDIT PËR TË MARRË MBI VETE DETYRIMET QË DALIN NGA ANËTARËSIMI NË BE



Civil Society Organisation  
**NEW HORIZON**  
Ulqin - Montenegro  
E-mail: [horizon@t-com.me](mailto:horizon@t-com.me)  
[www.ngo-horizonti.org](http://www.ngo-horizonti.org)

Mbështetur nga:



Kuvendi i Malit të Zi

